

Përfundimi i auditimit dhe procedurat e tij

Audituesi pas kryerjes së testeve të të dhënave dhe grumbullimin e të dhënave të audituara ai fillon të bëjë vlerësimin e tyre. Por, audituesi çdo herë para se të formojë dhe përfundojë raportin e auditimit ai merrë në shqyrtim edhe çështje tjera të cilat kanë ndikim në raportet financiare. Veprimet kryesore në fazën e kryerjes së auditimit janë:

- a) Shqyrtimi i obligimeve financiare potenciale
- b) Shqyrtimi i ngjarjeve pas datës së bilancit dhe
- c) Veprimet përfundimtare të vlerësimit të dhënave të audituara.*

Obligimet financiare potenciale kanë të bëjnë osë definoohen si gjendje ekzistuese ose grup rrethanash të cilat përmbajnë paqartësi duke shiquar në mundësit e humbjeve, e cila do të zgjidhet kur ndonjë ngjarje në të ardhmen do të realizohet. **Shembuj të obligimeve financiare potenciale mund të jenë: mosmarrëveshtje gjygjësore, mosmarrëveshtje tatimore, garancionet për shitjen e prodhimeve, dhe garancia për obligimet ndaj të tretëve.***

Audituesi me rastin e ndërmarrjes se veprimeve mbi përcaktimin e obligimeve financiare potenciale do të shërbehet me:

- hulumtimi i deturimeve të paregjistruara
- Rishikimi i procesverbaleve nga mbledhja e kuvendit, bordit të drejtorëve, dhe të drejtorve
- Shqyrtimin e kontratave dhe protokoleve nga mbledhjet afariste me përfaqësuesit e bankave dhe të besorsëve
- Shqyrtimi i obligimeve për tatimin në fitim dhe deklaratat tatimore
- Furnizimin e dokumentacionit i cili ka të bëjë me garancionet nga institucionet tjera dhe
- Kryerja e procedurave për të identifikuar humbjet kontigjente.

Hulumtimi i detyrimeve të paregjistruara përfshinë procedurat e realizuara afër datës së raportit të auditimit, siç janë egzaminimet e paresave në para pas datës së bilancit të gjendjes. Këto procedura janë të dizajnuara për identifikimin e detyrimeve të cilat kanë ekzistuar në datën e bilancit të gjendjes por nuk janë regjistruar si detyrime në pasqyrat financiare të klientit të audituar. Audituesit duhet t'i shiqojnë minutat e mbledhjeve të bordit të drejtorëve dhe aksionarëve, përfshirë edhe mbledhjet e organeve të bordit të drejtorëve siç janë komiteti i auditimit, komiteti i investimeve dhe komiteteve tjera. Ky rishikim përfshinë të gjitha mbledhjet e mbajtura deri në datën e raportit të auditimit. Audituesi për përfundimin e raportit të auditimit duhet të përcaktojë se janë marrë në konsiderat të gjithë minutat e mbledhjeve, përfshirë edhe minutat e mbledhjeve të realizuara pas datës së bilancit të gjendjes. Audituesit do ti sigurojnë me shkrim të gjithë minutat e mbledhjeve nga ana e menaxhmentit të kompanisë.

*Tusek, B., Zager, L., cit., faqe, 243-249.

*Prema: Messer, E.F., op. Cit. Str. 639. Medunardni revizijski standardi cit. Ivica Filipovic "Revizija" faqe, 128

Audituesi për të vërtetuar obligimet financiare potenciale aplikon një numër të caktuar të vëprimesh. Ai i trajton me menaxhmentin politikat dhe veprimet përcaktuese dhe të vlerësuarit e obligimeve financiare potenciale. Përgjegjësin për vendosjen e politikave dhe veprimeve në lidhje me përcaktimin, vlerësimin dhe përcjelljen kontabile të obligimeve financiare potenciale e ka menaxhmenti i kompanisë. Audituesi për verifikimin e këture obligimeve financiare potenciale i dërgon shkresë avokatit mrojtës të klientit të audituar mbi mosmarrëveshtjet gjyqësore dhe për paditë ekzistuese të klientit. Në praktikë audituesi më së shpeshti ballafaqohet me këto lloje të mosmarrëveshjeve gjyqësore: shkelja e ligjeve dhe dispozitave ligjore (mbi tatimin në fitim, mbrojtja e mjedisit), shrytëzimi i patentëve të pa autorizuar dhe vëprimet në kundërshtim të kontratave etj.

Audituesi për ta kryer auditimin e mosmarrëveshjeve gjyqësore kërkon nga menaxhmenti i klientit që ai të kërkojë nga avokati i tij që të dërgojë pytyet me shkrim që kanë lidhje me këto informacione:

- a) regjistrimin e të gjitha padive gjyqësore ekzistuese,
- b) regjistrimin e akuzave potenciale të cilat priten të jenë kundër klientit dhe
- c) përshkrimi dhe vlerësimi përfundimtar i të gjitha padive gjyqësore që janë duke rrjedhurë dhe atyre që do të vijnë.

Saj përketë pytyes së parë, përcjellësit në përgjithësi janë të gatshëm të sigurojnë të dhënat ekzistuese të padive gjyqësore, informacionet mbi paditë gjyqësore potenciale kundër klientit i japin pa dëshirë.

Me obligimet financiare potenciale janë të lidhura ngusht edhe obligimet që lindin nga kontratat afatgjate që realizimi i tyre pritet në të ardhmen. Shembuj të këtyre kontratave në afarizmin e kompanisë janë ato të blerjes së lëmdës së parë dhe materialit në një datë të caktuar ose të shitjes së produkteve të gatshme si pas çmimit fikës. Këto obligime sipas rregullave duhet të publikohen në formë të shpalosjeve me raportet financiare. Por, ekzistojnë situata të caktuara kur është e nevojshme që kompania të pranojë humbjen në bazë të obligimeve afatgjate të kontraktuara edhe pse nuk ka ardhur deri të këmbimi i të mirave. Shembull, nëse prodhuesi e ka paguar një meter shtof me çmim fikës 10 euro në Tetor të vitit vijues, e cila do të porositet në Maj të vitit të ardhshëm, kështu që me 31 Dhjetor të vitit vijues çmimi i tregut për një metër shtof ka rënë në 9 euro, është e qartë se kompania duhet ta pranojë humbjen në bazë të kontraktimit afatgjatë të obligimeve.

Humbjet kontigjente definoohen si humbje të mundshme të cilat rrjedhin nga aktivitetet e kaluara dhe të cilat do të zgjidhen si rezultat i ndonjë ngjarje në të ardhmen. Humbja kontigjente ka të bëjë me pasigurinë në lidhje me shumën e humbjes, dhe ndodhjes së humbjes. Termi humbje kontigjente përfshinë dëtimin e mundshëm të asetëve dhe ekzistencën e detyrimeve. Trajtimi Kontabël i Humbjeve Kontingjente bëhet nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit Financiar që i definon kriteret mbi trajtimin kontabël të humbjeve kontingjente.

Këto humje mund të prezentohen në evidencen kontabël nëse i plotësojnë këto dy kritere:

- Informacionet në dispozicion para publikimit të raporeteve financiare ofrojnë indikacione se mund të paraqiten këto humbje para datës së bilancit të gjendjes dhe
- Shuma e humbjes kontingjente mund të vlerësohet ose të matet në mënyrë të arsyeshme.

Humbjet kontingjente që nuk i plotësojnë këto kritere të lartëshënuara gjithësesi duhet të shpalosen në shenimet shpjeguese të raporeteve financiare kur ekziston një gjasë e arsyeshme se humbja është shkaktuar.

Shembull mbi ilustrimin e shpalosjes së detyrimit kontingjent në lidhje me çështjet gjyqësore të pazgjdhura.

Kompania është pjesëmarrse në një numër të madh të padive gjyqësore që rrjedhin nga veprimtaria e biznesit të saj, duke përfshirë transaksionet komerciale, detyrimet ndaj produkteve, si dhe çështjet me mjedisin, sigurinë dhe shëndetin. Rezultati përfundimtar i padive gjyqësore nuk mund të parashikohet me siguri të madhe. Menaxhmenti i kompanisë nuk pret që këto çështje të kenë efekte të kundërta materiale në bilancin kontabël dhe në pasqyren e të ardhurave.

Rreziku i përgjithshëm kontingjent përfaqësojnë humjet të cilat mund të ndodhin në të ardhmen, ndërsa humjet kontingjente përfaqësojnë humbet të cilat mund të kenë ndudhur në të kaluarën. Shembuj të rreziqeve të përgjithshme kontingjente janë: kërcnimet e protestave ose bojkoteve, rreziqët e ngjitjes së çmimeve të lëndës së parë si dhe rreziqet nga katastrofat natyrore. Rreziku i përgjithshëm kontingjent nuk ka nevojë të shpaloset në pasqyrat financiare.

Karakteristikat kryesore të obligimeve potenciale janë:

- 1) Fjala është për pagesat e ardhshme potenciale për ndonjë kompani të jashtme ose zvogëlimi i rëndësishëm i ndonjë forme tjetër të aseteve,
- 2) Ekzistonë josinguri në shumat e arshme të pagesave ose zvogëlimi i aseteve dhe
- 3) Mundësia e ndikimit në raportet financiare të kushtzuara nga përfundimet e ndonjë ngjarje në të ardhmen.

Procedurat e nevojshme të audituesëve në lidhje me humbjet kontingjente

Procedurat e nevojshme të audituesëve për identifikimin dhe vlerësimin e humbjeve kontingjente janë:

- 1) Rishikimi i procesvërbaleve nga mbledhja e bordit të drejtorëve deri në përfundimin e punës në terren, në bord diskutohen kontratat e rëndësishme, paditë e ndryshme gjyqësore dhe veprimet me degët e saja.

- 2) Letër konfirmimi dërguar avokatit të klienti duke kërkuar:
 - Shpjegim e natyrës së rasteve të pazgjidhura gjyqësore, padive potenciale dhe mosmarrëveshieve në lidhje me tatimet në fitim të kompanisë.
 - Vlerësimin e gjasave të humbjes së padive gjyqësore
 - Vlerësimi i humbjes potenciale ose pamundësia e përcaktimit të shumës së humbjes potenciale.
 - Vlerësimi i menaxhmentit në lidhje me paditë potenciale, të cilat nëse ngriten do të kenë efekte negative.
 - Deklarimin e shumave të pa-faturuara në lidhje me shërbimet ligjore të pranuar.
- 3) Letër konfirmimi dërguar institucioneve financiare për të kërkuar informata për detyrimet kontingjente.
- 4) Rishikimi i korespondencës me institucionet financiare për evidencë të shitjes ose të transferimit të llogarive të arkëtueshme.
- 5) Rishikimi i raporteve dhe korespondencës me agjencitë qeveritare për të identifikuar vlerësimet ose dënimet potenciale.
- 6) Sigurimi i letër përfaqësimit nga klienti se të gjitha detyrimet për të cilat zyrtarët e kompanisë janë në dijeni të plotë janë regjistruar dhe shpalosur në pasqyrat financiare.

Shqyrtimi i i ngjarjeve pas datës së bilancit(ngjarjet e mëvonshme)

Përgjegjësia e audituesit nuk është vetëm në hulumtimin e ngjarjeve deri në datën e ndërtimit të raporteve financiare por edhe në hulumtimin e ngjarjeve afariste pas datës së bilancit. Shfrytëzuesit e informacioneve nga raporti i auditimit mbi raportet financiare duhet të jenë të informuar nga audituesit se para se të hartohet raporti i ka marrë në konsideratë të gjitha ato ngjarje afariste të cilat kanë mundur të kenë ndikim të rëndësishëm në raportet financiare, dhe të cilat kanë qenë të njohura deri në datën e raportit të tij. Dy lloje të ngjarjeve janë të rëndësishme para se të lejohet raporti financiar dhe dhënjes së raportit të auditimit, të cilat menaxhmenti duhet t,i shqyrtojë dhe audituesi t,i vlerësojë.

Ekzistojnë dy lloje të ngjarjeve të mëvonshme:

- 1) Ngjarjet që kanë ekzistuar në ose para datës së bilancit të gjendjes dhe
- 2) Ngjarjet të cilat përfshin faktet të cilat janë paraqit pas datës së bilancit të gjendjes

Lloji i parë i ngjarjeve të mëvonshme ofrojnë të dhëna shtesë mbi faktorët të cilët kanë ekzistuar në ose para datës së bilancit të gjendjes dhe të cilët ndikojnë në vlerësimin e elementeve të raporteve financiare, dhe pastaj kërkojnë përmirësimin e shumave në raportet financiare. Ngjarjet pasuese të llojt të dytë të cilat janë paraqitura pas datës së bilancit të gjendjes. Këto ngjarje pasuese nuk kërkojnë korigjimin e raporteve financiare por janë paraqitur pas kësaj date, zakonisht kërkojnë publikimin për mes shpalosjeve në raportet financiare. Shqyrtimi i këtyre ngjarjeve ka për qëllim të pengojë marrjen e pamjës së gabueshme të përpilimit të raporteve financiare mbi gjendjen e afarizmit të kompanisë.

Shembuj të llojt të parë të ngjarjeve janë: a) kërkesat e pazgjedhura dhe të dyshimta nga keqësimi i vazhdueshëm i gjendjes financiare të blerësit që e çojnë kahë falimentimi pas datës së bilancit, llogaritë e arkëtueshme të një klientit më 31 Dhjetor përbëheshin nga një llogari e madhe dhe nga një numër i llogarive tjera më të vogëla. Menaxhmenti i kompanisë i trajtojë balancet e llogarive të mëdha si plotësisht të mbledhshme në datën e bilancit të gjendjes, por gjatë procesit të auditimit njëri nga klientët e kompanisë së audituar falimentoi. Audituesit gjatë procedurave të auditimit zbuluan që, edhe pse falimentimi ndodhi në fillim të Janarit, fuqia financiare e klientit të kompanisë së audituar ka qenë e përkeqësuar para datës 31 Dhjetor, dhe menaxhmenti i kompanisë thjesht ka gabuar duke menduar që llogaritë e arkëtueshme janë plotësisht të mbledhshme në datën e bilancit të gjendjes. Audituesi në këtë rast rekomandojë rritjen e lejimit për llogaritë e pambledhshme më 31 Dhjetor. Shembull tjetër, është vërtetuar se çeqet e klientit-pagesat në emër të llogarive të arkëtueshme të cilat më 31 Dhjetor janë përfshirë në totalin e llogarisë së parasë, janë të pambledhshme. Nëse shuma e çeqeve do të ishte materiale, atëherë balanca e parasë më 31 Dhjetor do duhej të korigjohet në mënyrë që të përjashtohen çeqet e pambledhshme.

Shemulli 3, një padi gjyqësore ndaj klientit është zgjidhur në pjesën e parë të Janarit pas datës së bilancit, dhe shuma e detyrimit është materiale. Shuma e padisë është dashur të shpalojë në shënimet shpjeguese të raporteve financiare, ndërsa detyrimi nuk është dashur të njihet pas që më 31 Dhjetor nuk ka qenë e mundur të bëhet kalkulimi i përafërt i humbjes potenciale. Pas zgjidhjes së rastit shuma e humbjes së klientit është e njohur dhe kjo humbje kontigjente e plotësojnë kriterin për tu regjistruara si detyrim kontigjent në bilancin e gjendjes më 31 Dhjetor në vend të shpalosjes së saj në shënimet shpjeguese të raporteve financiare.

b) vendosja e padive gjyqësore pas datës së bilancit ku shumat e caktuar në këto vendime janë të ndryshme nga shumat e paraqitura në raportet financiare që kanë të bëjnë me periodat deri në fund të vitit.

Shembuj të llojt të dytë janë (pas datës së bilancit të gjendjes): a) kompani ka blerë ose shitur aksione përkatësisht pjesë të afarizmit dhe b) humbja e pasurisë ose të pjesëve të saj si rezultat i fatëkeqësive natyruke (zjarrit, vërshimeve ose të ngjarjeve të paparashikuara).

Për këto lloje të ngjarjeve pas datës së bilancit, audituesi duhet të kërkojë publikimin dhe shpalosjen e tyre në raportet financiare. Veprimet e auditimit për hulumtimin e ngjarjeve të mëvonshme i përfshijnë veprimet të cilat aplikohen si pjesë përbërse e fazës së grumbullimit të të dhënave të audituara, shembull i testit cutoff ose testit të përkufizimit kohorë, por edhe veprime shtesë të cilat kryesisht janë të destinuara për identifikimin dhe vlerësimin e ngjarjeve të mëvonshme.

Këto ngjarje nuk kërkojnë korigjim të pasqyrave financiare,por ato duehet të shpalosen në shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare,sepse për ndryshe pasqyrat financiare do të jenë mashtruese.shembull,supozojmë se pas datës së bilancit klienti pëson dëme të mëdha të pa siguruara si rezultat i ndodhjes së një zjarri brenda ndërtesës së tij.Vlera e ndërtesës në bilancin e gjendjes nuk du të korigjohet pasi në datën e bilancit ndërtesa nuk ka qenë e dëmtuar.

Ngjarjet të cilat paraqiten pas datës së bilancit të gjendjes dhe që kërojnë shpalosje në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare,por para përfundimit të punes në terren janë:

- Kombinimi biznesor me një kompani konkuruase
- Shyerja e hershme e obligacioneve të pagueshme
- Adoptimi i një plani të ri pensional i cili kërkon shuma të mëdha afatshkurtra të parave
- Vdekja e drejtorit të thesarit në një aksident ajror
- Paraqitja e një linje të re të produkteve dhe
- Mbyllja e kompanisë si rezultat i grevave të punëtorëve.

Të gjitha këto ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit mund të kene një ndikim të madh në veprimtarinë e ardhshme të kompanisë,por këto ngjarje të nodhura nuk kanë kurfar ndikimi në rezultatet e periudhes kontabël të audituar,dhe efekti i tyre në rezultatet e ardhshme nuk mund të përcaktohet me saktësi.Tri ngjarjet e para të ndohura pasuese(kombinim biznesor me një kompani konkuruase,shyerja e hershme të obligacioneve të pagueshme dhe adoptimi i një plani të ri pensional i cili kërkon shuma të mëdha afatshkurtra të parasë) duhet të shpalosen në shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare.Ndërsa tri ngjarjet tjera të fundit pasuese janë çështje që nuk kanë të bëjnë më ngjarjet kontabile dhe nuk do të shpalosen në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Dallimet ndërmjet dy llojeve të ngjarjeve pasuese

Audituesi per të vendosur se një ngjarje pasuse është e nevojshme të korigjohet në pasqyrat finnaciare ose të shploset shënimet shpjeguese, ai duhet me kujdes të analizojë rrethant se si kanë ndodhë ngjarja.Shembul,me njëherë pas datës së bilancit të gjendjes,një klient i madh i kompanisë së audituar ka falimentuar,dhe si rezultat i kësaj llogaria e arkëtueshme e cila në datën e bilancit është konsideruar të jetë plotësisht e mbledhëshme tani më është e pambledhshme.Në qoftëse falimentimi i klientit të kompanisë ka qenë si rrjedhojë e përkeqësimit gradual të pozitës financiare,atëherë ngjarja pasuese ofronë evidencë që llogaria e arkëtueshme aktualisht nuk ka qenë e mbledhshme në datën e bilancit dhe si rezultat i kësaj duhet të rritet lejimi për lloraritë e pambledhshme në fund të vitit.Në rastin tjetër,kur falimentimi i klientit ishte si rrjedhojë e fatkeqësive madhore e cila ka ndodhur pas dates së bilancit,ne këtë rast ngjarja pasuese duhet të shpaloset në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Procedurat e auditimit në lidhje më ngjarjet pasuese

Veprimet fillestare përcaktuese të ngjarjeve të mëvonshme janë të shenuara në SNA 560- Ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes përfshijnë:

- Përseri rishiqimin e veprimeve të cilat i ka vendosur menaxhmenti që të sigurohet në përcaktimin e ngjarjeve pas datës së bilancit,
- Leximi i procesverbaleve nga mbledhjet e aksionarëve, bordit të drejtorëve, komitetit të auditimit të mbajtura pas periudhës ushtrimore dhe hulumtimi i pyetjeve mbi të cilat shqyrtohen në këto takime,
- Të mësuarit e të rejave të përkohëshme të raportimeve financiare të subjektit afarist, nëse është e nevojshme planet, parashikimi i rrjedhjes së parasë dhe të tjerat që kanë lidhje me raportet e menaxhmentit,
- Ngritja e pyetjeve ose sqarimi i pyetjeve plotësuse me gojë ose me shkrim avokatëve të subjektit afarist mbi seancat gjyqësore dhe kërkesat e dëmshpërblimit dhe
- Dhe të kërkuarit nga menaxhmenti të raportojë se mos ka ndodhur ndonjë ngjarje pas datës së bilancit e cila mund të ndikojë në raportimin financiar.

Audituesit pas identifikimit të ngjarjeve pas datës së bilancit duhet të vertetojnë se a janë paraqitur në mënyrë adekuate në pasqyrat financiare. Menaxhmenti i klientit është i obliguar ta informojë audituesin mbi ngjarjet e rëndësishme para se të publikoi raportin financiar. Audituesi së bashku me menaxhmentin e kompanisë duhet ti shqyrtojnë ato ngjarje që janë të nevojshme të korigjohen në pasqyrat financiare para se të publikohen këto raporte financiare.

Veprimet përfundimtare të vlerësimit të të dhënave të audituara

Audituesi për veçë shqyrtimit të ndikimit dhe ekzistimit të obligimeve potenciale financiare dhe hulumtimit të ngjarjeve pas datës së bilancit të gjendjes, ai i kryen edhe disa veprimet përfundimtare të vlerësimit të të dhënave të audituara para se të përfundojë formsimin e raportit të tij mbi përpilimin e pasqyrave financiare të klientit. Këto veprime janë fushë e përgjegjësisë së audituesit në pajtueshmëri me standartet, a qëllimi i tyre është t, i plotësojë të dhënatë e audituara dhe të grumbulluara në të gjitha fazat e shqyrtuara në proceset e auditimit të pasqyrave financiare dhe të shpreh opinionin mbi ndërtimin e pasqyrave financiare.

Konkretishtë, në këtë fazë të procesit të auditimit të raporteve financiare audituesi kryen veprimet analitike, pastaj vlerësimin përfundimtar të aftësisë së klientit se afaron në kohë të pakufizuar, letër përfaqsimin me deklaratën e menaxhmentit (representation letter) dhe bënë shiqimin përfundimtarë në dokumentacionin e punës.*

Ekzekutimi i veprimeve analitike përfundimtarë në procesi e auditimit të raportit financiar audituesi i bënë para përfundimit ose në fund të procesit të auditimit me qëllim të formsimit të përfundimit gjithëpërfshirës mbi raportimet financiare dhe afarizmit të kompanisë.

*Boris Tusek, Lajos Zager "Revizija" faqe, 247-248

Veprimet analitike që audituesi i kryen para përfundimit të angazhimit të tij kanë për qëllim lehtësimin e vlerësimeve përfundimtare të realizuar njëjtë mbi zëratë individual në raportet financiare si dhe në prezentimin e përgjithshëm të raporteve financiare. Përmes veprimeve analitike mund të rillogariten ndonjë, ose të gjithë treguesit të cilët si zakonishtë përlllogariten me rastin e planifikimit të auditimit. Në bazë të kryerjes së veprimeve analitike mund të tregohet se ekziston nevoja në hulumtimin shtesë të ndonjë pozicionit në raportet me qëllim të zvogëlohet rreziku dhënien e mendimit gabimisht.

Vlerësimi i aftësisë së kompanisë së afaron në pajtushmëri me supozimin se “afarizmi në kohë është i pakufizuar” audituesi duhet ta vlerësojë aftësinë e kompanisë se a mundet ta vazhdojë afarizmin edhe për një kohë të arsyeshme. Koha e arsyeshme mund të jetë një vit pas datës së bilancit të gjendjes. Por nëse vjenë në pyetje afarizmi në kohë i pakufizuar i kompanisë, audituesi duhet të ndër marrë këta hapa: së pari, duhet të shqyrtohen rezultatet e veprimeve të auditimit të cilat janë kryerë dhe gjatë auditimit kanë paralajmruar se ekzistojnë dyshime në vazhdimësinë e afarizmit të kompanisë deri në një kohë të arsueshme. Së dyti, nëse ekzistojnë dyshime të rëndësishme, audituesi duhet të grumbullojë informacione mbi planet e menaxhmentit për tejkalimin e kësaj situate dhe të vlerësimin real të kryerjes së këtyre planeve. Së treti, audituesi pas vlerësimin real të këtyre planeve vjenë në përfundim se ekzistojnë ende dyshime të rëndësishme në aftësinë e kompanisë për vazhdimin normal të afarizmit, prandaj duhet të shqyrtohet prap kjo pyetje në raportin e auditimit.

Kushtet të cilat ndikojnë në vazhdimin e afarizmit të ndonjë kompanie mund të jenë: trendet negative financiare, vështësitë tjera financiare, problemet e brendshme dhe ngjarjet e jashtme. Trendet negative financiare tregohen në rezultatet e dobëta afariste dhe me treguesit e dobët financiar. Aplikimi i veprimeve analitike gjatë auditimit do të jetë shumë i dobishëm për vërejtjet negative të trendeve financiare.

Trendet negative financiare dhe treguesit të cilët të dërgojnë në vështësitë financiare janë:

- Trendet negative financiare:
 - humbjet prej afarizmit të rregullt dhe humjet e akumuluar
 - kapitali negativ qarkullues-vlera neto negative e kompanisë
 - rrjedhja negative e parasë
- Treguesit:
 - kapitali/obligimet e përgjithshme
 - pasuria vijuese/obligimet vijuese dhe
 - treguesit tjerë(ekonomizimi, profitabiliteti etj.)

Këto vështësi mund të jenë arsye e mjaftueshme për të vënë në dukje dyshimet në kohë të pakufizuar të afarizmit për se cilën kompani.

Vështërsit tjera financiare janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e aftësisë afariste të kompanisë që të afaroj në kohë të pakufizuar.shembull,nëse kopania bënë shkeljen e obligimeve të kontraktuara,ose nuk i plotëson ato,atëherë kreditorët,kërkuesit e dividendëve mund të kërkojnë pagesë të dhunëshme.nëse kompani nuk mund të arrijë t,i plotësojë kërkesat ndaj besorsëve, atëherë në këto situatë financiare mund të fillohet hapja e procedurave të falimentimit ose të likuidimit të kompanisë.problemet interne,si janë të metat në prodhim mund të kenë pasoja serioze për afarizmin e kopanisë.në fund ngjarjet e jashtme mund ta kushtëzojnë drejtpërsëdrejti paaftësin e afarizmit të kompanisë që të afarojë në kohë të pakufizuar.shembull,në vështërsitë financiare të kompanisë e cili afaron në një fushë të lartë të teknologjisë është e mjaftueshme që të humbet blerësi kryesor.

Vështërsit tjera financiare,problemet e brendshme dhe ngjarjet e jashtme të çojnë në rrezikimin e kohës së pakufizuar të afarizmit të kompanisë.

Vështërsit tjera financiare janë:

- Mosplotësimi i obligimeve ndaj kreditorëve
- Dividentet e mbetura të papaguar
- Ristrukturimi i borgjit
- Furnitorët refuzojnë të furnizojnë klienti mbasi shtyhen pagesat dhe
- Nuk ekzistojnë burime shtesë të financimit.

Problemet e brendshme:

- Pengesat në prodhim
- Varësia mbi suksesin e një projekti të caktuar

Ngjarjet e jashtme:

- Veprimet gjyqësore
- Humja e blerësit kryesor ose të furnitorit dhe
- Humbja e liçencës ,patentës.

Të gjitha këto kushte të dërgojnë në pasiguri të një kohe të pakufizuar të afarizmit të kompanisë.prandaj audituesi është i detyruar të shqyrtojë planet e menaxhmentit që kanë lidhje me zgjidhjen e këtyre problemeve në veçanti në keto plane: shitja e pasurisë,ristrukturimi i borgjit ekzistues,zvogëlimi ose shtyerja e shpenzimeve dhe rrija e kapitalit të kontribuar.

Menaxhment bënë përpjekje të shesë tërë ose një pjesë të pasurisë së kompanisë me qëllim që të paguajë borgjin ose të përmbyll aktivitetet të cilat nuk janë profitabile.menaxhmenti mund të bisedojë me besorsitë mbi rustrukturimin e borgjit ekzistues.audituesi pas shqyrtimit të këtyre planeve të menaxhmentit vjenë në përfundim se ekzistin një dyshim i bazuar në aftësit e afarizmit të kompanisë në vazhdimin e afarizmit për një periudhë të arsyeshme,prandaj duhet të hulmtohojë ndikimet e mundshme të këtyre rrethanave në raportet financiare si dhe deklaratën në lidhje me këto.

